

URDHËR
Nr. 435, datë 6.7.2018

**PËR MOSRIPËRTËRITJEN E LICENCËS AGJENCISË AMP SI AGJENCI E
ADMINISTRIMIT KOLEKTIV NË FUSHËN E TË DREJTAVE TË PRODHUESVE TË
FONOGRAMEVE**

Në mbështetje të pikës 4, nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 134, 135, 157 dhe 158, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”; të udhëzimit nr. 5166, datë 20.10.2016, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të tjera shitesë në sqarim të kriterëve të parashikuara në nenin 133, si dhe përcaktimin e kushteve dhe procedurës së marrjes së licencës ose ripërtëritjen e saj, në bazë të nenit 134, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to””; si dhe kërkesës së agjencisë AMP për ripërtëritje të licencës me nr. 3364, datë 7.5.2018; të urdhrit të ministrit të Kulturës nr. 205, datë 4.4.2018, “Për ngritjen e grupit të punës, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për licencim/ripërtëritjen e tyre në fushat e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në administrimin kolektiv, në përputhje me kriteret dhe procedurat e parashikuara në ligjin 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, ndryshuar me urdhrin nr. 228, datë 17.4.2018, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 205, datë 4.4.2018”, si dhe legjislacionin në fuqi “Për organizatat jofitimprurëse”,

KONSTATOVA:

a) Gjatë shqyrtimit të dosjes së agjencisë AMP, agjenci e administrimit kolektiv në fushën e drejtave të prodhuesve të fonogrameve, rezulton mungesa e kontratave të reciprocitetit, si detyrim që buron nga ligji nr. 35/2016, ku përcaktohet si element specifik dhe kryesor për agjencitë e administrimit kolektiv, konkretisht, neni 135 dhe neni 137, si dhe udhëzimi nr. 5166, datë 20.10.2016, i Ministrit të Kulturës, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të tjera shitesë në sqarim të kriterëve të parashikuara në nenin 133, si dhe përcaktimin e kushteve dhe të procedurës së marrjes së licencës ose ripërtëritjen e saj, në bazë të nenit 134, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”;

b) Pas verifikimeve të kryera pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për secilin anëtar të kësaj agjencie, si dhe në zbatim të nenit 159 pika “c” dhe “e”, të ligjit nr. 35/2016, rezultojnë se anëtarët e kësaj agjencie, bazuar të drejtave që agjencia përfaqëson, konkretisht si agjenci e administrimit kolektiv të të drejtave të producentëve, një pjesë e tyre nuk gëzojnë statusin për të qenë prodhues fonogrami, si dhe përfitues të shpërblimeve që agjencia mbledh në emër dhe për llogari të tyre;

c) Rezulton se një prej anëtarëve të AMP-së është në konflikt interesi e parashikuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, me drejtuesin e agjencisë AMP dhe në shkellje të nenit 133/2/“ii”, të ligjit nr. 35/2016, ku dispozitat statutoire të agjencive të administrimit kolektiv duhet të marrin parasysh parimin e transparencës, parimin e konfliktit të interesit në organet e tyre drejtuese, si dhe parimin e mosdiskriminimit midis anëtarëve, anëtarëve dhe joanëtarëve, si dhe midis përdoruesve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të. Rezulton se drejtuesi i AMP-së është njëkohësisht edhe ortak i subjektit “Albatrade Plus”, me 50% të kuotave, fakt ky i verifikueshëm në ekstraktin e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;

d) Bazuar kriterëve që përcakton udhëzimi nr. 5166, datë 20.10.2016, ka mungesa në dokumentacionin mbi kualifikimin dhe formimin e punonjësve që agjencia ka të kontraktuar në pozicionin jurist/ekonomist/financier apo trajnime të kryera në fushën e të drejtave të autorit,

URDHËROJ:

1. Mosripërtëritjen e licencës së agjencisë AMP, si agjenci e administrimit kolektiv në fushën e të drejtave të prodhuesve të fonogrameve.

2. Ngarkohet Drejtoria e së Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.

3. Kundër këtij urdhri, kërkuesi ka të drejtën e ankimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I KULTURËS
Mirela Kumbaro Furxhi